



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
MINISTRI

Nr. 5111/L
Prot

Tiranë, më 25/06/2025

UDHËZIM

Nr. 13 Datë 25 / 6/2025

“PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË RREGJISTRIT TË PERSONAVE FIZIK E JURIDIK QË KANË DETYRIMIN PËR TË PAGUAR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE SIPAS KATEGORISË SË DETYRIMEVE TATIMORE, PËRFSHIRË PËRJASHTIMET APO LEHTËSIMET FISKALE PËR KATEGORI TË CAKTUARA TAKSAPAGUESISH”

Në mbështetje pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 12, të ligjit nr.68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar”, pikës 7 të nenit 4, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar”,

U D H Ë Z O J:

I.DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë dhe qartësojë rregulla të qarta, rolin, përgjegjësitë dhe procedurat për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit të Personave Fizikë e Juridikë që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifatat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish.
2. Termat që janë përdorur në këtë udhëzim kanë kuptimin e përcaktuar sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

3. Regjistri i Personave Fizikë e Juridikë që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish, në vijim Regjistri, përfshin gjithë informacionin bazë që lidhet me taksapaguesit persona fizikë (individ, individ të vetëpunësuar apo individ tregtar), ambulantët dhe entitetet/personat juridikë detajuar sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish.
4. Në krijimin dhe mbajtjen e Regjistrit, NJVQV-të bashkëpunojnë me institucione dhe entitete të tjera publike dhe private. Ky bashkëpunim siguron që shkëmbimi i informacionit, në përputhje me marrëveshjet e lidhura, të realizohet duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave.
5. NJVQV, sipas procedurave të brendshme të miratuara nga Kryetari, janë përgjegjëse për përditësimin e vazhdueshëm të Regjistrit për të reflektuar ndryshimet ligjore, demografike e socio-ekonomike që kanë efekt në taksat e tarifat vendore.
6. Informacioni për taksapaguesit i mbledhur, regjistruar dhe i administruar në përputhje me këtë Udhëzim, trajtohet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin që rregullon procedurat tatimore dhe mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri.
7. Për të siguruar informacionin e nevojshëm për hartimin e politikave dhe harmonizim më të mirë me kuadrin ligjor fiskal kombëtar, NJVQV-të përgatisin vazhdimisht raporte dhe/ose informacion statistikor mbi taksat e tarifat vendore dhe taksapaguesit vendorë, që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish.

II. PROCEDURAT PËR PËR KRIJIMIN, MBAJTJEN DHE PËRDITËSIMIN E REGJISTRIT

1. Çdo NJVQV, bazuar në legjislacionin që rregullon vetëqeverisjen vendore, financat vendore, sistemin e taksave vendore dhe procedurat tatimore në Shqipëri, harton dhe miraton rregullore të brendshme për procedurat që ndiqen, strukturat përgjegjëse dhe afatet për mbledhjen, regjistrimin, përditësimin, dhe konsolidimin e informacionit për taksapaguesit vendor përfshirë statusin e aktivitetit, nga vetë NJVQV dhe /ose në bashkëpunim me institucione të tjera publike.
2. NJVQV-të, ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që të gjithë taksapaguesit, persona fizik (individ, individ të vetëpunësuar apo individ tregtar), ambulantë, dhe entitete/persona juridik, që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe vendimeve të Këshillave Bashkiak, janë identifikuar dhe përfshirë në Regjister.

3. Informacioni për taksat e tarifat vendore dhe taksapaguesit vendorë, që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish, përcaktohet në Aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
4. Informacioni mbi taksapaguesit vendor administrohet vetëm nga nëpunësit dhe punonjësit e administratës tatimore vendore, të cilët janë të caktuar me Vendim të Këshillit Bashkiak për të administruar taksat dhe tarifat vendore.
5. Shkëmbimi i informacionit, në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara nga administrata tatimore vendore, kryhet me kushtin që të ruhet konfidencialiteti i të dhënave tatimore nga institucionet dhe individët që kanë akses në to.
6. Ky regjistër përmban:
 - a. Llojet e taksave dhe tarifave vendore në fuqi për vitin buxhetor në territorin e NJVQV-së;
 - b. Bazën e taksës;
 - c. Nivelin sipas taksave dhe tarifave vendore;
 - d. Listën e personave fizikë (individ, individ tregtar ose i vetëpunësuar), ambulantëve dhe entiteteve/personave juridikë që kanë detyrimin të paguajnë taksat dhe tarifat vendore sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish;
 - e. Të ardhurat e planifikuara dhe të mbledhura sipas llojeve të taksave dhe tarifave vendore, dhe kategorive kryesore të taksapaguesve;
 - f. Të dhëna për detyrime të tjera tatimore (taksa/tarifa të papaguara nga vitet paraardhëse tatimore, gjoba dhe kamatëvonesa).
7. Regjistri mirëmbahet dhe përditësohet në mënyrë periodike me qëllim reflektimin e ndryshimeve ligjore dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak për taksat dhe tarifat vendore të aplikueshme në territorin e NJVQV-së.

III. FORMA E RREGJISTRIT

1. Regjistri i Personave Fizikë e Juridikë që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, krijohet dhe mbahet në formë elektronike.
2. Ky regjistri duhet të:
 - a. sigurojë përputhshmëri me standardet më të larta të sigurisë dhe privatësisë;
 - b. ofrojë mundësinë e kërkimit dhe filtrimit të të dhënave;
 - c. ofrojë mundësinë e rishikimit dhe përditësimit të të dhënave;
 - d. ofrojë mundësinë e përpunimit statistikor, analizës dhe raportimit të të dhënave.

IV. BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL PËR KRIJIMIN, MBAJTJEN DHE PËRDITËSIMIN E REGJISTRIT

1. Njësitë e Vetëqeverisjes V endore (NJVQV), lidhin marrëveshje bashkëpunimi me njëra tjetrën, me organe dhe agjenci të pushtetit qendror, entitete të tjera publike e private, të cilat disponojnë informacion të nevojshëm në lidhje me statusin dhe veprimtarinë e taksapaguesve, informacion i cili është i domosdoshëm për realizimin e një administrimi efikas të taksave dhe tarifave vendore.
2. Marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit duhet të përfshijnë të paktën, informacionin që do të shkëmbehet, mënyrën e shkëmbimit të informacionit, nivelin e aksesimit si dhe pikat e kontaktit.
3. Marrëveshjet nënshkruhen me institucionet si më poshtë, por pa u kufizuar në to:
 - a. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
 - b. Drejtoritë Rajonale Tatimore;
 - c. Qendra Kombëtare e Biznesit;
 - d. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
 - e. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë;
 - f. Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
 - g. Enti Kombëtar i Banesave;
 - h. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;
 - i. Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSHEE sh.a;
 - j. Ndërmarrjet e Ujësjetës kanalizimeve që operojnë në territorin e NJVQV-ve;
 - k. Ministrinë.
4. NJVQV-të përdorin informacionin e marrë, vetëm për përditësimin e Regjistrit në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë qëllim, NJVQV-të adoptojnë rregullore të brendshme për të siguruar trajtimin e duhur dhe konfidencial të informacionit.

V. RAPORTIMI STATISTIKOR NË MINISTRINË E FINANCEVE

1. NJVQV-të, dërgojnë informacion statistikor në Ministrinë e Financave sa herë që kërkohet, por të paktën një herë në vit për:
 - a. Llojet e taksave dhe tarifave vendore në fuqi për vitin buxhetor në territorin e NJVQV-së;
 - b. Bazën e taksës;

- c. Nivelin sipas taksave dhe tarifave vendore;
- d. Listën e personave fizikë (individ, individ tregtar ose i vetëpunësuar), ambulantëve dhe entiteteve/personave juridikë që kanë detyrimin të paguajnë taksat dhe tarifatat vendore sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish;
- e. Të ardhurat e planifikuara dhe të mbledhura sipas llojeve të taksave dhe tarifave vendore, dhe kategorive kryesore të taksapaguesve;
- f. Të dhëna për detyrime të tjera tatimore (taksa/tarifa të papaguara nga vitet paraardhëse tatimore, gjoha dhe kamatëvonesa);

VI. KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Mosdërgimi i informacionit statistikor pranë Ministrisë së Financave, sipas përcaktimeve të nenit 12, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar”, dënohet me gjobë nga nëpunësi i parë autorizues sipas parashikimeve të nenit 61 të këtij ligji.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. NJVQV-të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregulloreve të brendshme brenda 4 muajve, nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi.
2. Ngarkohen NJVQV-të dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



ANEKSI NR. 1. INFORMACIONI MBI TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE SI DHE TAKSAPAGUESIT E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

I.TË DHËNAT PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE

1. Lloji dhe niveli i taksës vendore;
2. Baza e taksës vendore;
3. Lloji dhe niveli i tarifës vendore;
4. Periudha tatimore gjatë të cilës zbatohet taksa dhe tarifa vendore;
5. Përrjashtimet e mundshme nga taksa dhe tarifa vendore;
6. Lehtësimet e mundshme nga taksa dhe tarifa vendore;
7. Periudha gjatë të cilës aplikohen përrjashtimet dhe lehtësimet e mundshme nga taksa dhe tarifa vendore.

II.TË DHËNAT E REGJISTRIT PËR PERSONAT FIZIK (INDIVID TREGTAR DHE I VETËPUNËSUAR)

1. Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT);
2. Emri tregtar i personit të tatueshëm;
3. Kodi i Aktivitetit Ekonomik (kodi ekonomik i veprimtarisë së biznesit sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike dhe përshkrimi i veprimtarisë ekonomike që ushtrohet);
4. Objekti i aktivitetit (aktiviteti i kryer, duke specifikuar llojin e veprimtarisë ekonomike);
5. Statusi i aktivitetit;
6. Adresa: Rruga/Qyteti/Bashkia;
7. Numri i telefonit;
8. Data e regjistrimit në regjistrin tregtar;
9. Lloji i detyrimit tatimor;
10. Niveli i taksës/tarifës;
11. Baza e taksës;
12. Totali i detyrimit tatimor;
13. Periudha tatimore vjetore/periodike;
14. Afatet e pagesës.

III.TË DHËNAT E REGJISTRIT PËR PERSONAT FIZIK (INDIVID)

1. Numri i identifikimit personal (ID) të deklaruesit;
2. Emri, Atësia dhe Mbiemri;
3. Nënshtetësia e individit;
4. Vendbanimi i individit (Adresa: Rruga/Qyteti/Bashkia);
5. Numri i telefonit;
6. Lloji i detyrimit tatimor;
7. Niveli i taksës/tarifës;

8. Baza e taksës;
9. Totali i detyrimit tatimor;
10. Periudha tatimore vjetore/periodike;
11. Afatet e pagesës.

IV.TË DHËNAT E REGJISTRIT PËR AMBULANTËT

1. Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS);
2. Emri tregtar i personit të tatueshëm;
3. Kodi i Aktivitetit Ekonomik (kodi ekonomik i veprimtarisë së biznesit sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike dhe përshkrimi i veprimtarisë ekonomike që ushtrohet);
4. Objekti i aktivitetit (aktiviteti i kryer, duke specifikuar llojin e veprimtarisë ekonomike);
5. Vendi kryesor i ushtrimit të aktivitetit;
6. Adresa: Rruga/Qyteti/Bashkia;
7. Numri i telefonit;
8. Data e regjistrimit në regjistrin tatimor;
9. Lloji i detyrimit tatimor;
10. Niveli i taksës/tarifës
11. Baza e taksës;
12. Totali i detyrimeve tatimore;
13. Periudha tatimore vjetore/periodike;
14. Afatet e pagesës.

V.TË DHËNAT E REGJISTRIT PËR ENTITETET/PERSONAT JURIDIK

1. Numri i Identifikimit të Subjektit të Tatueshëm (NIPT);
2. Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm, që është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në certifikatën e NIPT-it;
3. Emri dhe mbiemri i Administratorit;
4. Numri i identifikimit personal (ID) e Administratorit;
5. Kodi i aktivitetit ekonomik (kodi ekonomik i veprimtarisë së biznesit sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike dhe përshkrimi i veprimtarisë ekonomike që ushtrohet);
6. Objekti i aktivitetit (aktiviteti i kryer, duke specifikuar llojin e veprimtarisë ekonomike, i cili ndihmon në kategorizimin e taksave dhe tarifave vendore);
7. Statusi i aktivitetit;
8. Adresa; Rruga/Qyteti/Bashkia e personit të tatueshëm;
9. Numri i telefonit;
10. Forma ligjore e aktivitetit;

11. Data e regjistrimit, vendi dhe numri i regjistrimit;
12. Lloji i detyrimit tatimor;
13. Niveli i taksës/tarifës;
14. Baza e taksës;
15. Totali i detyrimit tatimor;
16. Periudha tatimore vjetore/periodike;
17. Afatet e pagesës.

VI.TË DHËNAT PER TAKSEN MBI PASURINE E PALUAJTSHME (NDËRTESE,TOKË BUJQËSORE DHE/OSE TRUALL URBAN):

1. Emri, Atësia dhe Mbiemri i pronarit/pronarëve;
2. Datëlindja;
3. Vendlindja;
4. Numri Personal i Identifikimit/ ose NIPT kur pasuria është biznes;
5. Adresa e pronës/zona fiskale sipas VKM (në rastin e pasurisë ndërtesë);
6. Forma e pronës (publike, private, bashkëpronësi);
7. Adresa e banimit të pronarit;
8. Numri i kontaktit/adresë email;
9. Lloji i pasurisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall);
10. Sipërfaqja në m2;
11. Data e regjistrimit dhe zona kadastrale (nëse është e regjistruar);
12. Identifikimin si ndërtesë e parë për banim ose tjetër;
13. Lloji i përdorimit/destinacioni (banesë ose biznes);
14. Të dhëna për përdoruesin dhe/ose qiramarrësin;
15. Planimetria e pronës;
16. Dokument/autorizim përfaqësimi të bashkëpronarëve.